



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:223942
Datë: 07.06.2022
Numri i dokumentit: 03104338

K.nr.1005/21

Gjykata Themelore Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni për Kundërvajtje, sipas gjyqtarit Menderes Behluli dhe zyrtares ligjore Erzë Mustafa, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Sh. D nga fsh.... K.Gjilan, për shkak të veprës kundërvajtëse të paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit **36 paragrafi 3**, të Ligjit mbi Pyjet nr.2003/3, Ligjit nr.2004/29 dhe nenit 14, të Ligjit nr.03/L-153/2010 mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës i Kuvendit të Kosovës, e konform nenit 55 pika 1 dhe 2, 86, 119 dhe 124, të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me datën **07.06.2022** shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit Sh. D nga babai N..., i lindur më ..., nga fsh.... K.Gjilan ku edhe jeton, i pa punë, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës Kosovës.

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Sepse me datën **20.09.2021** aty rreth orës **14:00** min. të lartepërmendurën pylltari e ka takuar në vend të ngjarjes në territorin e fshatit Pogragjë, në vendin e quajtur “Grajevc”, duke preprë me sharrë motorrike 72 copa dru bungu, me diameter 8-10 cm, me gjatësi 5 m, e që bartjen e bënte me traktor “IMT 539” me qerre gome, i njejtë Agjencisë Pyjore i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 153.60 euro.

-me ç’veprim ka kryer veprën kundërvajtëse, të paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit **36 paragrafi 3**, të Ligjit mbi Pyjet nr- 2003/3, Ligjit nr-2004/29 dhe nenit 14, të Ligjit nr. 03/L 153/2010, mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr, 2003/3, për Pyjet e Kosovës i Kuvendit të Kosovës, andaj

D E N O H E T

Me dënim me gjobë në larësi prej **70 (shtatëdhjetë) €**, të cilën gjobë, i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor t'i paguajë kësaj gjykate shumën prej **5 €** , në afat të njëjtit sikurse gjobën, konform nenit 109 paragrafi 1 pika 6, të LMK-së.
Nga një kopje e aktgjykimi t'iu dorëzohet palëve në procedurë.

A r s y e t i m

A.P.K–ja, në Gjilan, me datën **22.09.2021** ka paraqitur kërkesën me nr...., për inicimin e procedurës kundervajtëse, kundër të pandehurit të lartëshenuar dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe ndëshkohet sipas ligjit.

Gjyqtari shqyrtoi kërkesën dhe konstatoi se e njëjta është e ligjshme.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike ftoi të pandehurin me ftesë që të paraqitet në gjykatë, i cili në deklaratën e tij theksoi se është e vërtetë se me datën **20.09.2021** në ora **14:00** min, në territorin e fshatit Pogragjë, në vendin e quajtur “Grojeve” vërtetë ka shkuar në pyll shtetëror për të mbledhur disa dru kryesisht të thata nuk përjashtohet mundësia se ka prerë edhe ndonjë të njomë të thyer nga fryma dhe i kishte për shfrytëzim për nevoja familjare, për djegie duke theksuar se nuk është person që meret me kontrabandimin e druve por ndonjëherë i shfaqet nevoja për të shkuar në pyll për nevoja familjare, shumë rrallë dhe për këtë më vie keq, kërkon ndjesë, kërkon falje, lut gjykatën që të mer parasysh këto rrethana si lehtësuese dhe me rastin e vendojtes t'i shqiptoj një dënim sa më të vogël minimal.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjyqtari mori në pyetje personin zyrtar pylltarin O. I në cilësinë e dëshmitarit i cili deklaroi se vërtetë me datë datë **20.09.2021** në orën **14:00** min në terrenin e fsh.Pogragjë, në vendin e quajtur “Grajevc” , të lartëpermendurin e ka takuar në vend të ngjarjes duke bërë prerë dru të bungut me sharrë motorrike ku kishte prerë 72 copa, me diameter 8-10 cm, me lartësi 5 m, i transportonte me traktor IMT 539 me qerre gome.

Gjyqtari pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, deklaratave të të pandehurit dhe personit zyrtar dëshmitarit erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit, ekzistojnë prova të mjaftueshme, se i pandehuri është kryerës i veprës kundervajtëse prerje dhe transportimi ilegal i druve, vepër kjo e paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit **36 paragrafi 3**, të Ligjit mbi Pyjet nr.2003/3, Ligjit nr.2004/29 dhe nenit 14, të Ligjit nr.03/L-153/2010 mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/3 për Pyjet e Kosovës i Kuvendit të Kosovës, për të cilën të njëjtin e shpalli përgjegjës dhe e ndëshkoi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjyqtari me rastin e shqiptimit të dënimit mori për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 31 të LMK-së, pati parasysh peshën dhe pasojat e veprës kundervajtëse, rrethanat në të cilën është kryer vepra kundervajtëse dhe të njëjti i shqiptoi këtë dënimin nën minimumin e paraparë ligjor konform nenit 35 të LMK-së, me bindje se edhe me një dënim të këfillë do të arrihet efekti i dënimit tek i pandehurit që në të ardhmen mos të kryej vepra të tilla kundervajtëse .

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2021:223942
Datë: 07.06.2022
Numri i dokumentit: 03104338

**Gjykata Themelore Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm
Divizioni për Kundërvajtje,
Me datën 07.06.2022**

**Zyrtarja ligjore,
Erzë Mustafa**

**Gjyqtari,
Menderes Behluli**

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, paraqitësi i kërkesës dhe pala e pandehur mund të paraqesin ankesë në afat prej 8 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit- Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate.